



NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (KRRE) solli vendimin, me të cilin bëhet **ulja** e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht **3,84 %** në raport me vendimin e datës 26.5.2026.

Çmimet referente të derivateve të naftës në tregun botëror, në krahasim me përlogaritjen e mëparshme shënojnë ulje mesatarisht: te benzina për 10,867 %, te nafta për 10,622 %, te vaji ekstra i lehtë për 10,136 % dhe te mazuti për 8,238%.

Kursi i denarit në raport me dollarin në periudhën e kaluar, sipas të cilit janë formuar çmimet në përlogaritjen e mëparshme, është më i lartë për **0,0272%**.

Në këtë përlogaritje është marrë parasysh shuma e ulur e akcizave për 2,00 den/l te EURODIZELI (D-E V) dhe te benzinat EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98.

Nga data 2.6.2026, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

Benzinë motori	EUROSUPER BS - 95	88,00 (denarë/litër)
Benzinë motori	EUROSUPER BS – 98	90,00 (denarë/litër)
Naftë motori	EURODIZEL BS (D-E V)	85,50 (denarë/litër)
Vaj për Djegie	Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	87,50 (denarë/litër)
Mazut M-1 SU		47,906 (denarë/kilogram)

Çmimet e shitjes me pakicë të **EURODIZELIT (D-E V)** dhe të **Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1)** ulen për **6,50 denarë/litër**.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës **EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98** rriten për **0,50 den/l**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **Mazutit M-1 SU** ulet për **3,238 den/kg** dhe tani do të jetë **47,906 den/kg**.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 2.6.2025. Tregtarët me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës dhe të karburanteve për transport mund të vendosin çmime të veçanta për derivatet e naftës dhe të karburanteve për transport edhe më të ulëta se çmimet më lartë të përcaktuara.

1.6.2026

